



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SHKENCËS

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI

Nr. 473/13 Prot, datë 27.02. 2013

Nr. 150 Prot, datë 20.02. 2013

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NDËRMJET KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në vijim të quajtura “Palët”)

Duke vlerësuar rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;

Duke u angazhuar përmarrjen përsipër përsigurimin e të gjitha mjetave të nevojshme përmbrrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin të së drejtës për arsimim;

Duke konsideruar si domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e të drejtës për arsimim mbështetur në parimin e barazisë përparrë ligjit dhe barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë;

Duke afirmuar vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe

kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;

Duke u mbështetur në kuadrin e plotë ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” dhe legjislacionin dhe aktet nënligjore që rregullojnë sistemin arsimor;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim “Memorandumi”).

Neni 1 Objekti i Memorandumit

1.1 Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për objekt ndalimin e sjelljeve diskriminuese dhe përcaktimin e rregullave e modaliteteve brenda të cilave Palët do të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre, për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi në sistemin arsimor, ofrimin e shanseve të barabarta dhe të drejtës të të gjithëve për t'u arsimuar, programet arsimore, masat me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim.

Neni 2 Angazhimet e palëve dhe format e bashkëpunimit

2.1 Palët angazhohen dhe do të bashkëpunojnë me njëra tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara nga Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” sipas fushave të veprimtarisë që ata mbulojnë, bashkëpunim i cili do të përfshijë:

1. shkëmbim ekspertize dhe angazhim reciprok për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushat respektive;
2. bashkëpunimin për adresimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të ankesave për diskriminim nga drejtuesit e institucionit arsimor;
3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës angazhohet të mbështesë aktivitetet monitoruese të Komisionerit përmes DAR/ZA;
4. përfshirjen në programet mësimore të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit si dhe të koncepteve dhe veprimeve kundër modeleve të sjelljeve diskriminuese;
5. mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok;
6. shkëmbim informacioni dhe njohurish;

7. organizim i fushatave të përbashkëta sensibilizuese dhe trainimeve, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit;
8. ndërhyrje e përbashkët institucionale për të garantuar arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuar, si dhe personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;
9. kryerjes së analizave të përbashkëta, me synim evidentimin e problemeve të personave që janë ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit si dhe marrjen e masave pozitive dhe forcimin e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi;
10. organizimin e tryezave të përbashkëta dikutimi, për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, me qëllim përfshirjen e masave të reja që garantojnë trajtimin e barabartë dhe eleminimin e parashikimeve diskriminuese nga legjislacioni aktual;
11. bashkëpunim në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare që i shërbejnë realizimit të detyrimeve të përbashkëta që rrejdhin nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;

2.2 Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen.

Neni 3 Komunikimi i Palëve

- 3.1 Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përbashkët e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore.
- 3.2 Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Memorandumit të Bashkëpunimit.
- 3.3 Personat e kontaktit nga të dyja palët do të janë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.
- 3.4 Me anë të përfaqësuesve të dyja Palët do të përcaktojnë radhën e mbledhjeve të grupeve të punës, kohëzgjatjen dhe periodicitetin e këtyre mbledhjeve.

Neni 4 Dispozita Përfundimtare

4.1 Ky Memorandum Bashkëpunimi lidhet pa afat të caktuar.

4.2 Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e memorandumit, duke njoftuar palën tjetër 30 ditë para.

4.3 Memorandumi mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, bazuar në pëlqimin e ndërsjelltë të Palëve të paraqitur me shkrim.

4.4 Në rast mosmarrëveshje të dyja Palët i zgjidhin ato nëpërmjet negocimit dhe mirëkuptimit.

4.5 Ky Memorandum Bashkëpunimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, dy për secilën palë.

4.6 Ky Memorandum Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Palët.

Nënshkruar në Tiranë, më 24/02/2013.

**PËR MINISTRINË E
ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Myqerem TAFAJ



**PËR KOMISIONERIN
PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

Irma BARAKU

